

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Projekti "Tarraca të Sistemuara, Interaktive, Multifunksionale dhe pjesërisht të gjelbëruara".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 22114311-5.

Vlera e Fondit Limit: **15.990.000 (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 11, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 12.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 11 të DST-së.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019,2020,2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: "40% të vlerës së parashikuar të kontratës ne procedurat e prokurimit..... dhe ne procedurat e prokurimit "Shërbim Konsulence", si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare", si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar

në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se zotëron pjesë të stafit të tij “ekspertët kryesorë” për realizimin e këtij shërbimi si më poshtë:

Për të vërtetuar këtë, OE duhet të paraqesë: listën emërore të ekspertëve kryesorë, kontratën e punës ose

marrëveshjen e angazhimit për këtë procedurë të prokurimit, CV-të, dhe diplomat universitare perkatëse si pjesë e ofertës teknike.

- a. **1 (një)Ekspert Kryesor/Menaxher Projekti** – Eksperti Kryesor/Drejtuuesi i ekipit duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 3 vite në menaxhimin e projekteve. Diplomë Universitare në nivel Master në ekonomi, shkencë sociale, planifikim urban ose ndonjë fushë tjetër të ngjashme.
- b. **1 (një) Inxhinier Ndërtimi** – Eksperti duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 3 vite në projektim, vlerësim strukturash, preventivim, etj. Diplomë Universitare në nivel Master në inxhinieri ndërtimi ose ndonjë fushë tjetër të ngjashme.
- c. **1 (një) Inxhinier Elektrik** – Eksperti duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 3 vite në projektim, vendosje panelesh fotovoltaike, etj. Diplomë Universitare në nivel Master në inxhinieri elektrike ose ndonjë fushë tjetër të ngjashme.
- d. **2 (dy) Arkitektë** – Me eksperiencë jo më pak se 3 vite pune në planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Diplomë Universitare në nivel Master në Planifikim urban, arkitekturë ose ndonjë fushë tjetër të ngjashme.
- e. **1 (një) Ekspert Ekonomie** – Me eksperiencë jo më pak se 3 vite me financat vendore dhe buxhetimin e dokumenteve strategjike. Diplomë Universitare në nivel Master në financë, ekonomi ose ndonjë fushë tjetër të ngjashme.
- f. **1 (një) Ekspert Ligjor** – Eksperti duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 3 vite. Diplomë Universitare në nivel Master në juridik.
- g. **1 (një) Ekspert i Mjedisit** – Me eksperiencë jo më pak se 3 vite pune në fushën e mjedisit. Diplomë Universitare në nivel Master në inxhinieri mjedisi, shkencë mjedisi ose ndonjë fushë tjetër të ngjashme.

Shënim: Kriteri 2.3.2 dhe nënparagrafi e tij do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.

- Dokumentacioni provues, i kërkuar në pikën 2.3.2 (Staf) duhet të ngarkohet nga OE, si pjesë e ofertës teknike për efekt të vlerësimit me pikë.

Një ekspert nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...] VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 41, pika 4.

Per përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen. Qëllimi i kërkesës për këtë nivel dhe lloj ekspertize është që autoriteti kontraktor të garantohet që operatori ekonomik ka aftësinë e nevojshme në nivel stafi teknik për të kryer detyrën specifike të projektit, që ka një rëndësi të vecantë për autoritetin kontraktor.

Numri i përcaktuar për secilin specialist është përllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës dhe është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë kontratë.

Konkretisht: Argumenti për stafin

Eksperti i Planifikimit Strategjik/Menaxheri i Projektit do të jetë përgjegjës për organizimin e grupit të konsulentëve, përmbushjen në kohë të afateve të kontratës, mbajtjen e kontakteve me AK, kontrollin e cilësisë së dokumentacionit të prodhurar, etj.

Kërkesa për një Konsulent Planifikimi Strategjik/Menaxheri i Projektit i garanton autoritetit të drejtë prioriteteve të tij duke i orientuar ato drejt përdorimit më të mirë të burimeve, duke arritur misionin, qëllimet dhe objektivat e kontratës në tërësi.

Inxhinieri i Ndërtimit do të jetë përgjegjës për vlerësimin e gjendjes aktuale të ndërtesave, kostimin e zgjidhjeve të propozuara, etj.

Inxhinieri Elektrik do të jetë përgjegjës vlerësimin e mundësisë së implementimit të vendosjes së paneleve fotovoltaike, vlerësimin e kostove të implementimit, përllogaritjen e kursimit të energjisë, etj.

Arkitektët do të jenë përgjegjës për ideimin e ndërhyrjeve, përgatitjen e plan-vendosjeve dhe dizajneve paraprake, përllogaritjen e kostove të implementimit, etj.

Eksperti i Ekonomisë do të jetë përgjegjës për analizën financiare, përcaktimin e kostove të ndërhyrjeve të propozuara, përpilimin e analizës kosto-benefit dhe buxhetimin e plotë të projektit.

Eksperti Ligjor do të jetë përgjegjës për analizën e kuadrit ligjor brenda të cilit vepron AK dhe propozimin e zgjidhjeve ligjore për propozimet e ndryshme të projektit.

Eksperti i Mjedisit do të jetë përgjegjës për vlerësimin e ndikimit të mundshëm mjedisor të propozimeve të strategjisë.

**Për të gjithë këta ekspertë, përveç diplomave në fushat përkatëse, është kërkuar një eksperiencë pune prej të paktën 3 (tre) vjetësh pasi gjykojmë se kjo përvojë është minimumi i mundshëm që duhet të ketë një ekspert për të implementuar kërkesat e kontratës.*

Gjithashtu vitet e eksperiencës së punës në sektor janë të rëndësishme pasi konsulenti duhet të dëshmojë një sërë aftësish dhe një nivel pjekurie të caktuar në menaxhimin e prioriteteve të kontratës dhe planifikimit eficient.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/

termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Objektivi i përgjithshëm i kësaj kontrate konsulence është përgatitja e një Studimi Fizibiliteti për rivitalizimin e tarracave të objekteve arsimore publike në Bashkinë e Tiranës, duke përfshirë krijimin e tarraceve të gjelbëra me funksion rekreative, sportive apo zhvillimin e bujqësisë urbane, si edhe gjenerimin e energjisë së rinovueshme. Rivitalizimi i këtyre tarracave do të sillte:

- *Shtimin e gjelbërimit në qytet;*
- *Cilësi më të mirë jetese dhe reaktiviteti për fëmijët;*
- *Përmirësim të cilësisë dhe shkallës së peisazhit;*
- *Përmirësimin e cilësisë së ajrit;*
- *Përfitim të energjisë së gjelbër dhe kursimin e burimeve të energjisë nga rrjeti;*
- *Ulje të shpenzimeve për energjinë e harxhuar në këto objekte;*
- *Përdorimin e mirë të ujërave të reshjeve;*
- *Përdorimin e këtyre tarracave si laboratorë të hapur për çështjet mjdisore apo të energjisë;*
- *Promovimin e bimësisë së zonës së Tiranës.*

Qëllimi

Nëpërmjet krijimit të tarracave multifunkionale të gjelbëruara dhe me panele diellore të integruara për gjenerimin e energjisë elektrike të aplikuara në një pjesë të këtyre objekteve (kopshte, shkolla), fëmijët do të mund të marrin edhe edukatën medisore dhe mund t’ua transmetojnë prindërve të tyre, duke krijuar në këtë mënyrë një bashkveprim natyrë-familje si dhe krijimin e një modeli i cili mund të aplikohet më vonë edhe në ndërtesat private. Duke qënë se praktika të tilla po përhapen gjerësisht në rajon, por duke qënë edhe të vetëdijshëm për kapacitetet tona për zgjidhje të tilla, ne kërkojmë të bëjmë një studim fizibiliteti për integrimin e kësaj zgjidhjeje. Ky studim do të duhet të japë përgjigje për disa çështje që praktikisht do të jenë pjesë e kësaj ideje.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specififikimet teknike/termat e referencës, kërkesat funksionale dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **”Tarraca të Sistemuara, Interaktive, Multifunkionale dhe pjesërisht të gjelbëruara”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverballi:

Dokumentat e tenderit;